



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr.1235/9 Prot.

Tiranë, më 28/04/2017

V E N D I M

Nr. 34, Datë 28/4/2017

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË MAT “MBI ZBATIMIN E
PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE” PËR
PERIUDHËN 01.07.2014 DERI 31.12.2016.**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt vendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Qeverisjes Vendore shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15, dhe 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për auditimin e përputhshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” të ushtruar në Bashkinë Mat, për periudhën 01.07.2014 deri më 31.12.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA ORGANIZATIVE

1 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Mat për vitin 2015-2016, nuk ka miratuar strategjinë e risqeve, si dhe nuk ka hartuar regjistrin e riskut për asnjë njësi menaxheriale. Këto veprime janë në kundërshtim me kreun III- komponentët e menaxhimit financiarë dhe kontrollit, mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtarit e kontrollit, informacioni dhe komunikimi e monitorimi të, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

1.1 - Rekomandim: Kryetari i Bashkisë Mat të marrë masa, për ngritjen e sistemit të shëndoshë të menaxhimit financiarë, sisteme efektive të kontrollit të brendshëm bazuar në një analizë të vazhdueshme risku.

Në vijimësi

2 - Gjetje nga auditimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat, në lidhje me debitorët sipas bilancit të vitit 2016, të krijuara nga Njësia Administrative Burrel, Koms, Baz, Lis, Macukull, Derjan, Ulzë dhe Rukaj, nuk ka kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin në vlerën **45,168,449 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën g neni 12, të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

2.1 - Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat të marrë masa, të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e debitorëve në vlerën **45,168,449 lekë**.

Në vijimësi

3 - Gjetje nga auditimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat, detyrimet të prapambetur dhe vijues të paraqitura në bilancin e vitit 2016, si ndërtim shkollash, mirëmbajtje objektsh, urash, hartim projektsh, shërbim pastrimi etj., nuk i ka shlyer në vlerën **57,433,593 lekë**, veprim në papajtueshmëri me shkronjën gj neni 12, të ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

3.1 - Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat të marrë masa, të bëjë brenda afateve ligjore shlyerjen e detyrimeve në vlerën **57,433,593 lekë**, duke nxjerrë në çdo rast përgjegjësitë për këto detyrime të shtuara.

Në vijimësi

4 - Gjetje nga auditimi: U konstatua se Bashkia Mat në 6 transaksione financiare, në vlerën 1,118,000 lekë, për ngjarjet kulturore dhe artistike nuk ka hartua program, nuk ka përcaktuar fondin limit dhe datën përfundimtare për paraqitjen e ofertave nga operatorët dhe agjencitë. Komisioni, nuk ka kërkuar oferta nga operatorët e specializuara, nuk ka përcaktuar kushtet e veçanta, si dhe nuk ka hartuar një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin ia paraqet titullarit të institucionit, veprim në papajtueshmëri me pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1173, datë 06.11.2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”.

4.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, për ngjarjet kulturore dhe artistike të hartoj program pune, të përcaktoj fondin limit dhe datën përfundimtare për paraqitjen e ofertave nga operatorët dhe agjencitë. Komisioni të hartojë **një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur**, raport të cilin t’ia paraqes titullarit të institucionit.

Në vijimësi

5 - Gjetje nga auditimi: U konstatua se Bashkia Mat në 2 transaksione financiare, në vlerën 2,149,512 lekë, ka rezultuar se në procedurën e kufizuar dhe me negociim, nuk ka vendosur objektin e kontratës. Edhe në ftesat e bëra për operatorët ekonomik nuk është përcaktuar objekti i kontratës por vetëm vlera, ndërsa për kandidatin fitues ka mangësi në dokumentacionin përkatës, pasi objekti sipas Ekstrakti i QKR, nuk përputhet me objektin e prokurimit, veprim në papajtueshmëri me pikën 1 neni 40, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për prokurimet publike”, të ndryshuar, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimeve publike”, të ndryshuar.

5.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, në procedurën e kufizuar dhe me negociim, të eliminojë prokurimet të cilët cenojnë procesin që realizojnë sigurimin e mallrave dhe shërbimeve.

Në vijimësi

6 - Gjetje nga auditimi: U konstatua se Bashkia Mat në 55 transaksione financiare, me vlerë 1,118,000 lekë ka paraqitur për miratim në këshillin e Bashkisë ndihmë financiare për familje në nevojë pa dokumentacionin mbështetës, si certifikatën familjare, të ardhurat nga toka bujqësore, blegtoria etj., veprim në papajtueshmëri me pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

6.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, që të ndërpritet praktika e deritanishme e kalimit për miratim të ndihmës financiare dhe plotësimin e dokumenteve sipas kërkesave.

Në vijimësi

7 - Gjetje nga auditimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat për vitin 2015-2016, nuk ka bërë rivlerësimin e pasurive të paluajtshme të transferuara me çmimin e tregut, si dhe nuk i ka pasqyruar në aktivet e qëndrueshme të trupëzuara në bilanc si: tokë, troje, terren, pyje, kullota, plantacione, tokë bujqësore, ndërtesa, vendstrehime etj., me qëllim vënien në eficientësi të tyre dhe sigurimin e të ardhurave të cilat kanë një vlerë të konsiderueshme për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me kapitullin e II, të VKM nr. 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”.

7.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, për pasqyrim të drejtë të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara të bilancit si: troje, terren, pyje, kullota, plantacione, tokë bujqësore, ndërtesa, vendstrehime etj. me qëllim vënien në eficientësi të tyre dhe sigurimin e të ardhurave të cilat kanë një vlerë të konsiderueshme për buxhetin e Bashkisë Mat.

Në vijimësi

8 - Gjetje nga auditimi: Komisioni i inventarizimit në Bashkinë Mat, nuk ka hartuar **një raport** lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës. Komisioni, aktivet që vlerësohen e nxirren jashtë përdorimit nuk i ka grumbulluar në magazinë me fletëhyrje, si dhe **materialet që i ka asgjësuar nuk i ka marrë me fletëdalje nga magazina**, veprim në papajtueshmëri me germën e pikës 3 neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, me pikën 35, germën c pika 85, pikën 103, 104, 106, 109, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar dhe germën d të pikës 15, UMB nr. 1151, datë 16.7.2007 “Për kriteret dhe procedurat e vlerësimit dhe asgjësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe qarkulluese në sistemin e Ministrisë Brendshme”.

8.1 - Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat të marrë masa, që komisioni i inventarizimit të hartojë raport lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, duke përcaktuar kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës, dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit, t’ia dorëzojë për veprime të mëtejshme nëpunësit autorizues. Komisioni, aktivet që vlerësohen e nxirren jashtë përdorimit t’i grumbulloj në magazinë me fletëhyrje, ndërsa materialet për asgjësim t’i marrë me fletëdalje nga magazina.

Në vijimësi

9 - Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Macukull sot Njësi Administrative e Bashkisë Mat, me urdhër shpenzim nr. 116, datë 29.08.2014, në vlerën **492,000 lekë**, ka hartuar studim projektim për rrugën “Shqefen-Shell”, ndërsa projekti nuk është paraqitur në llogarinë 202 të bilancit të vitit 2014, veprim në papajtueshmëri me nenin 9, 10 e 12, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

9.1 - Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat të marrë masa, të paraqesë në bilancin e vitit 2017 në llogarinë 202 vlerën **492,000 lekë**, studim e projektim të rrugës “Shqefen-Shell”, ish-Komuna Macukull sot Njësi Administrative e Bashkisë Mat.

Në vijimësi

10 - Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit në Bashkinë Mat, nuk i ka bërë inventarizimin e dokumentacionit në lidhje me lejet zhvillimore të ndërtimit, veprim në papajtueshmëri me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”.

10.1 - Rekomandime: Drejtoria e Urbanistikës dhe Planifikimit të Territorit në Bashkinë Mat të marrë masa, të bëjë inventarizimin e dokumentacionit për lejet zhvillimore të ndërtimit.

Në vijimësi

11 - Gjetje nga auditimi: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit në Bashkinë Mat në 3 raste, nuk ka zbatuar vendimet për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi, veprim në papajtueshmëri me **ligjin nr. 183**, datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”.

11.1 - Rekomandime: Inspektorati i Mbrojtjes Territorit dhe Urbanistikës në Bashkinë Mat të marrë masa, të ndjek të gjitha procedurat ligjore për prishjen e 3 ndërtimeve pa leje ndërtimi.

Në vijimësi

12 - Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mat dhe 7 ish-komunat aktualisht Njësi administrative: Baz, Derjan, Koms, Lis, Macukull, Rukaj dhe Ulzë, mungojnë regjistrat e subjekteve fizik, juridik, shtetërorë dhe abonentëve familjarë. Mungojnë njoftim detyrim për taksat dhe tarifave vendore, për evidentimin e numrit të familjeve që duhet të paguajnë, veprim në papajtueshmëri me pikën 7 neni 3, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar.

12.1 - Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mat të marrë masa, për krijimin e regjistrat elektronik me të dhëna, për: Hapjen e kartelave individuale të subjekteve fizikë, juridikë dhe abonentëve familjarë, hartimin e planit vjetor të kontrollit sipas drejtimeve të përcaktuara në dispozitat ligjore, hartimin e regjistrat themelorë të subjekteve fizike, juridike dhe abonentët familjarë për taksat e tarifave vendore, duke evidentuar detyrimet për çdo taksë.

Në vijimësi

13 - Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mat dhe 7 Njësitë Baz, Derjan, Koms, Lis, Macukull, Rukaj dhe Ulzë u konstatua se në fund të vitit 2016 janë debitorë për taksat dhe tarifave vendore 358 subjekte në shumën 68,838,416 lekë dhe nga 10324 familje në vlerën 4,859,137 lekë, për taksat dhe tarifave vendore. Për vjeljen e këtyre debitorëve Sektori i Taksave Vendore nuk ka ndjekur procedurat e nevojshme ligjore për arkëtimin e debitorëve, në kundërshtim me nenin 4, 26, 32, 34, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nenin 90, 91, të ligjit nr. 9920 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenin 12 të Udhëzimit të Ministrisë Financave nr. 24, datë 02.09.2008, Kreu i XI-Mbledhja me forcë të detyrimeve.

13.1 - Rekomandimi: Nga Sektori i Financës dhe Sektori i Taksave në Bashkinë Mat, të merren masa për arkëtimin e detyrimeve tatimore dhe të bëhen njoftim vlerësimet tatimore, për 358 subjekte debitorë në shumën 68,838,416 lekë, bazuar në nenin 70 pika 3 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar, duke ndjekur rrugët e mëposhtme:

a - Tu dërgohen bankave urdhra bllokimi për llogaritë bankare, bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

b - Të dërgoj në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurose (për mjetet) dhe në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bazuar në nenin 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

c - Për subjektet të cilët nuk paguajnë detyrimet tatimore në afat, të llogaritet kamat vonesa (gjobë në masën 0,06 % kamat vonesë të detyrimit në ditë por jo më tepër se 365 ditë), bazuar

në nenit 114, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

13.2- Rekomandimi: Sektori i Taksave në Bashkinë Mat të marrë masa, të hartojë listën elektronike për abonentët familjare, si dhe të kërkojë arkëtimin e vlerës 4,859,137 lekë, sipas të dhënave të Gjendjes Civile, duke dërguar njoftim vlerësimet abonentëve familjarë me Postë, për:

- Njësia Administrative Burrel, tarifë shërbimi për 4854 familje me vlerë 1,200,000 lekë dhe taksë ndërtese në vlerën 393,675 lekë;
- Njësia Administrative Bazë, taksë toke për 857 familje me vlerë 543,000 lekë;
- Njësia Administrative Derjan, taksë toke për 925 familje me vlerë 652,462 lekë;
- Njësia Administrative Lis, taksë toke për 1166 familje me vlerë 430,462 lekë;
- Njësia Administrative Koms, taksë toke për 1081 familje me vlerë 640,538 lekë;
- Njësia Administrative Rukaj, taksë toke për 920 familje me vlerë 648,000 lekë;
- Njësia Administrative Ulzë, taksë toke për 521 familje me vlerë 351,000 lekë.

Në vijimësi

14 - Gjetjet nga auditimi: Në Bashkinë Mat dhe në ish-komunat Koms, Ulzë, Lis dhe Bazë kanë ushtruar aktivitet 69 subjekte të cilët nuk janë të regjistruar në QKR, duke sjellë mos arkëtimin e detyrimeve për taksat e tarifave vendore në vlerën 1,077,373 lekë, që përbëjnë të ardhura të munguara me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë, veprime në papajtueshmëri me nenin 40 e 41, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

14.1 - Rekomandimi: Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Mat të marrë masa, të njoftojë zyrtarisht Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër duke kërkuar regjistrimin e **69 subjekteve** në QKR dhe të kërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e detyrimeve në vlerën **1,077,373 lekë**, të cilët kanë ushtruar aktivitet të pa licencuar sipas pasqyrës nr. 10, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Në vijimësi

15 - Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunën Ulzë, sot Njësia Administrative e Bashkisë Mat, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore ushtron aktivitet subjekti “H...” për ndërtimin e linjës me gjatësi 5 km dhe subjekti “V...” sha për ndërtim antene me sipërfaqe 300 m².

- Në ish-Komunën Rukaj, sot Njësia Administrative e Bashkisë Mat, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore ushtron aktivitet subjekti “P...” për ndërtim hidrocentrali me sipërfaqe 25000 m² për të cilën është lidhur kontratë qiraje.

- Në ish-Komunën Lis, sot Njësia Administrative e Bashkisë Mat, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore ushtron aktivitet subjekti “M...” sha, për ndërtimin e antenës me sipërfaqe 400 m² dhe subjekti “V...” sha për ndërtimin e antenës me sipërfaqe 300 m².

- Në ish-Komunën Koms, sot Njësia Administrative e Bashkisë Mat, për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore ushtron aktivitet subjekti “S...” shkp, për ndërtim hidrocentrali me sipërfaqe 3600 m².

Nga ish-komunat sipërfaqet e dhëna me qira nuk kanë riklasifikuar fondin pyjor/kullosor, veprim në papajtueshmëri me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me pikën 6 neni 17, të ligjit nr. 9693 datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor”, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008 “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10.2008 “Për rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016.

15.1 - Rekomandimi: Bashkinë Mat të marrë masa, t’i kërkojë Ministrisë Mjedisit evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private “H...”, “V...” sha, “P...” shkp, “M...” sha

dhe “S...” shpk, duke rikualifikuar fondin pyjor dhe kullosor, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore të mbetura. Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

Në vijimësi

16 - Gjetje nga auditimi: Në ish-Komunat Derjan, Lis, Macukull dhe Ulzë sot Njësi Administrative të Bashkisë Mat, kryejnë aktivitetet për shfrytëzim karriere 7 subjekte, të cilët kanë në përdorim 213.41 ha sipërfaqe pyjore/kullosore të shfrytëzueshme. Këto subjekte nuk kanë lidhur kontratë për sipërfaqet që ato kanë në përdorim në vlerën **93,897,400 lekë**, duke krijuar mungesë të ardhurash me efekt negativ në buxhetet e Bashkisë, veprim papajtueshmëri me nenin 38 dhe pikën 1 e 2 të nenit 40/1, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, VKM nr. 22, datë 09.01.2008 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve të administrimit të pyllit komunal”, me pikën 4, 6 dhe 11, të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar lidhja 2.

16.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, dhe në bashkëpunim me Njësitë Administrative Derjan, Lis, Macukull dhe Ulzë, të bëjë evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private duke i hequr nga fondi pyjorë dhe kullosorë, si dhe t’i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimin e veprimtarisë së kompanive minerare deri në lidhjen e kontratave për arkëtimin qirasë në vlerën 93,897,400 lekë, si:

- në vlerën 1,321,400 lekë për sipërfaqen 3.01 ha nga subjekti “S...” shpk;
- në vlerën 53,108,000 lekë për sipërfaqen 120.7 ha nga subjekti “E...” shpk;
- në vlerën 4,400,000 lekë për sipërfaqen 10 ha nga subjekti “S...” shpk;
- në vlerën 880,000 lekë për sipërfaqen 2 ha nga subjekti “K...” shpk;
- në vlerën 10,560,000 lekë për sipërfaqen 24 ha nga subjekti “B...” shpk;
- në vlerën 7,128,000 lekë për sipërfaqen 16.2 ha nga subjekti “S... & A...” shpk;
- në vlerën 16,500,000 lekë për sipërfaqen 3.3 ha nga subjekti “F...” shpk.

Në vijimësi

17 - Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mat, dosjet teknike të investimeve janë mangësi në dokumentacion, veprim në papajtueshmëri me pika 4, paragrafi 4, të UKM nr. 1, datë 16.06.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar.

17.1 - Rekomandim: Drejtoria e Urbanistikës, Planifikimit dhe Menaxhimit të Territorit në Bashkinë Mat të marrë masa, të plotësoj me dokumentacion e nevojshëm tekniko ligjor dosjet teknike të investimeve.

Në vijimësi

18 - Gjetje nga auditimi: Inspektorati për Mbrojtjen e Territorit Mat në 2 raste në vlerën 100,000 lekë nuk ka arkëtuar gjopa për ndërtime pa leje ndërtimi, veprim në papajtueshmëri me nenin 15, të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar.

18.1- Rekomandime: Kryeinspektori i Inspektoratit për Mbrojtjen e në Bashkinë Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **100,000 lekë**, përkatësisht:

- në vlerën 50,000 lekë nga O.K.;
- në vlerën 50,000 lekë nga A.K.

Brenda muajt Gusht 2017

19 - Gjetje nga auditimi: Në Bashkinë Mat, nga 15 masa organizative të rekomanduara nga KLSH-ja me shkresën nr. 1567, datë 16.10.2014, janë zbatuar **8 masa** dhe nuk janë zbatuar **7**

masa, veprim në papajtueshmëri me nenin 15 shkronja (j) dhe nenin 30 pika 2, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

19.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, të zbatojë rekomandimet e lënë nga KLSH-ja, duke hartuar program pune dhe duke nxjerrë përgjegjësit përkatëse për secilin sektor apo zyrë.

Në vijimësi

20 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Mat, nga 2 masa shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH-ja ka zbatuar 1 masa dhe nuk ka zbatuar 1 masa me vlerë 3,921,049 lekë nga subjekti “K...” shpk, veprim në papajtueshmëri me nenin 15 shkronja (j) dhe nenin 30 pika 2, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

20.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, të zbatojë rekomandimet e lënë nga KLSH-ja dhe të rikërkojë në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin në vlerën **3,921,049 lekë** nga subjekti “K...” shpk.

Brenda muajt Gusht 2017

B - MASA SHPËRBLIM DËMI:

Mbështetur në nenet 98-102 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 21-33 të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe pikën 93 të UMF, nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nga ana e titullarit të njësisë publike, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore) duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. **Nëpunësi zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryej regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **34,268,289 lekë, si më poshtë:**

1 - Gjetje nga auditimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat, ka blerë pjesë ndërrimi për ekipin e Çiklizmit në vlerën 100,000 lekë, ndërsa sipas inventarit Bashkia Mat, nuk ka në përdorim biçikleta. Sipas fletë daljes nr. 6, datë 01.06.2015, pjesët e ndërrimit për biçikleta i janë bërë dalje Xh.T, i cili nuk është punonjës i Bashkisë. Blerja e pjesëve të ndërrimit për biçikleta në vlerën **100,000 lekë**, përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pikën **iii** shkronja **a** neni 9, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

1.1 - Rekomandimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **100,000 lekë**, përkatësisht:

- në vlerën 33,333 lekë nga M.S. me detyrë ish-Nën/Kryetar Bashkie;
- në vlerën 33,333 lekë nga V.B. me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Financës;
- në vlerën 33,333 lekë nga M.K. ish-specialist i kulturës dhe sporteve.

Brenda muajt Gusht 2017

2 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Mat, për shkak të ristrukturimit për ndërprerje të marrëdhënies së punës ka dhënë shpërblim për **2 punonjës** në vlerën **202,572 lekë**, pa motivuar, pa justifikuar dhe pa mbështetur në ligj, duke shkaktuar dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pikën 1, 2, 6, të nenit 50, të ligjit nr. 152, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me pikën **iii** shkronja **a** neni 9, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **202,572 lekë** përkatësisht:

- në vlerën 104,805 lekë nga E.D.
- në vlerën 97,767 lekë nga E.D.

Brenda muajt Gusht 2017

3 - Gjetje nga auditimi: Bashkia Mat për vitin 2014-2015-2016, në 22 raste me vlerë **12,136,432 lekë** ka paguar punonjësi të larguar nga puna me vendim të Gjykatës së Apelit Tiranë, pa u shprehur me vendim Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ Tiranë. Gjithashtu, në 2 raste Gjykata e Lartë Kolegji Administrativ Tiranë, ka rrëzuar vendimet e gjykatës së shkallës së Parë dhe të Apelit, si dhe në 20 raste sipas faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, **statusi i çështjes është mbyllur**, veprim në papajtueshmëri me pikën **iii** shkronja **a** neni 9, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

3.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **12,243,622 lekë**, përkatësisht nga 22 persona (sipas tabelës).

Brenda muajt Gusht 2017

4 - Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Bazë sot Njësi Administrative e Bashkisë Mat, me fletë daljen nr. 5, datë 08.04.2014, ka marrë dru zjarri 40 m³ me vlerë 128,776 lekë dhe fletë dalje nr. 4, datë 23.03.2015, ka marrë dru zjarri 40 m³ me vlerë 106,280 lekë. Sipas inventarit ekonomik të vitit 2014-2015, zyrat e ish- komunës Bazë nuk kanë në përdorim soba për ngrohje me dru zjarri, por për ngrohje administrata e komunës ka përdorur soba gazi, reflektor dhe kondicioner, si pasoj shkarkimi i magazinës është bërë në mënyrë të paligjshme nga M.L. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës dhe L.D. me detyrë ish-magaziniere, veprim në papajtueshmëri me germa **a** pika 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

4.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **235,056 lekë**, përkatësisht:

- në vlerën 128,776 lekë nga M.L;
- në vlerën 106,280 lekë nga L.D.

Brenda muajt Gusht 2017

5 - Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Komsi sot Njësia Administrative e Bashkisë Mat, ka zhvilluar trajnim për 14 ish-anëtarët e këshillit të komunës në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit dhe hartimin e planit administrative të tokës. Anëtarët e këshillit të komunës nuk mund të trajnohen për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe hartimin e planit administrative të tokës, pasi nuk është detyrë e anëtarëve të këshillit që të miratojnë leje ndërtimi dhe të hartojnë planin administrativ të tokës. Gjithashtu nuk ndodhet programi i trajnimit të anëtarëve të këshillit, data, vendin, temat e trajnimit dhe materialet e përgatitura nga referuesit në lidhje me urbanizimin, miratimin e lejeve të ndërtimit dhe hartimin e planit administrative të tokës.

Anëtarët e këshillit të komunës janë dërguar për guit turistike në Sarandë dhe Vlorë, pasi nuk ndodhet dokumentacioni në lidhje me shpenzimet e kryera për guit turistike me vlerë **442,800 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik për buxhetin e ish-komunës Komsi, veprim në papajtueshmëri me germën **a** pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

5.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **442,800 lekë**, përkatësisht për **14** ish-këshilltarë (sipas tabelës).

Brenda muajt Gusht 2017

6 - Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Rukaj sot Njësia Administrative e Bashkisë Mat, me urdhër shpenzim nr. 136, datë 12.08.2014, në vlerën 239,900 lekë, ka organizuar drekë me rastin e festës lokale “Kuvendi i Bruçit”, ndërsa shpenzimet e kryera me rastin e festës lokale

për pritje përcjellje në shumën **194.700 lekë**, përbën shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik për buxhetin e komunës, veprim në papajtueshmëri me VMK nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar me germa a pikën 3, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

6.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **197,700 lekë**, përkatësisht:

- në vlerën 97,350 lekë nga H.Gj. me detyrë ish-kryetari i komunës Rrukaj
- në vlerën 97,350 lekë N.O. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës së Financës.

Brenda muajt Gusht 2017

7 - Gjetje nga auditimi: Zyra e Financës në Bashkinë Mat, me urdhër shpenzimet në favor të firmës “S...” shpk ka paguar më shumën se vendimi i gjykatës vlerën **52,945 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik për buxhetin e Bashkisë Mat, veprim në papajtueshmëri me ligjin me pikën **iii** shkronja a neni 9, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, shkronjën g neni 12, ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

7.1 - Rekomandime: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **52,945 lekë**, nga “S...” shpk.

Brenda muajt Gusht 2017

8 - Gjetje nga auditimi: Ish-Bashkia Burrel, ish-komunat Derjan, Ulzë, Rukaj, Lis, Baz, Komsj dhe Macukull, sot Njësi Administrative Bashkia Mat, pagesën e anëtareve të Këshillit Bashkiak e kanë kryer pa marrë pjesë në mbledhje, duke paguar padrejtësisht në vlerën **3,722,777 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dem ekonomik për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me pikën 2 nenin 29, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të ndryshuar.

8.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga anëtarët e këshillit të Bashkisë Mat, në vlerën **3,722,777 lekë** sipas Anekseve nr. 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 dhe 8, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajt Gusht 2017

9 - Gjetje nga auditimi: Pronat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Mat, nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) me sipërfaqe **2401.38 m²**, me **40 apartamente**, Bashkia ka miratuar qira maksimale dhe minimale për banesa, por nuk ka lidhur kontratë qiraje, si dhe nuk ka llogaritur dhe arkëtuar të ardhura në vlerën **7,505,365 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dem për buxhetin e Bashkisë Mat, veprim në papajtueshmëri me nenin 2, të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin, të ndryshuar, me pikën 2 neni 39/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar dhe VKM nr. 260, datë 24.02.2010 “Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë, kur banesat sociale me qira financohen nga buxheti i shtetit ose buxheti i bashkive apo nga kombinimi i të dyjave”.

9.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, të lidhë kontratë qiraje me persona të cilët i përdorin apartamentet, si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **7,505,365 lekë** sipas pasqyrës nr. 14, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajt Gusht 2017

10 - Gjetje nga auditimi: Pronat që kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Mat, nga Enti Kombëtar i Banesave (EKB) rezulton se vlera e qirasë është llogaritur për një periudhë 5 vjeçare, ndërsa vlera e qirasë duhet të ishte llogaritur nga momenti i kalimit në pronësi të apartamenteve nga EKB dhe marrjes në dorëzim nga bashkia. Për periudhën para privatizimit të banesave është llogaritur dhe arkëtuar më pak qira në vlerën **328,502 lekë**, që përbën shkelje të

disiplinës financiare me dëm për buxhetin e Bashkisë Mat, veprim në papajtueshmëri me nenin 39/1, të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004 “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane”.

10.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **328,502 lekë**, sipas pasqyrës nr. 15, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Brenda muajt Gusht 2017

11 - Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Rukaj sot Njësi Administrative e Bashkisë Mat, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor me sipërfaqe 25000 m² ka lidhur kontratë qiraje me datë 06.05.2013 me subjektin “P...” shpk. Afati i kontratës është 9 vjeçar, vlera e qirasë vjetore është për shumën 275,000 lekë, e cila nga të dhënat e zyrës së financës është likuiduar. Vlera e qirasë është llogaritur sipas VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, me 11 lekë/m², kur në fakt vlera e kontratës duhet të llogaritet sipas lidhjes 2, pika 11/6 për 110,000 lek/km/vit (8.344 km x 110,000 lek/km/vit = 917,840 lekë) dhe për ndërtimin e hidrocentralit (Stacionit) lidhja 2, pika 8/6 për 143,000 lek/ha/vit (0.08 ha x 143,000 lek/ha/vit = 11,440 lekë) gjithsej për vlerën 929,280 lekë, duke mos llogaritur diferencën për 3 vite në vlerën **1,962,840 lekë, me dëm ekonomik në buxhet**, veprim në papajtueshmëri me pikën 11/6 lidhjen 2, të VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”.

11.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, të ndryshojë kontratën e qirasë sipas dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe ndjek të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,962,840 lekë** nga subjekti “P...” shpk.

Brenda muajt Gusht k 2017

12 - Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Ulzë sot Njësi Administrative e Bashkisë Mat, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor ka lidhur Akt-Marrëveshjen datë 05.08.2012 me subjektin “H...” sha për ndërtimin e linjës 6 kë me gjatësi 5 km, me afat kontrate 1 vit me të drejtë rinovimi, vlera e qirasë është për shumën 300,000 lekë, e cila është llogaritur sipas VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 15 “Ndërtim linje tensioni të lartë”.

Nga të dhënat e marrë në zyrën e taksave dhe sektorin e financës, rezulton se subjekti “H...” sha me NIPT.... nuk ka likuiduar detyrimet për 4 vitet respektivisht 2013,2014,2015 dhe 2016, gjithsej në vlerën **1,200,000 lekë**, e ardhur e munguar me dëm në buxhet, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin”.

12.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat në bashkëpunim me Njësinë Administrative Ulzë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e aktmarrëveshjes datë 05.08.2012 dhe arkëtimin e vlerës **1,200,000 lekë**, nga subjekti “H...” sha me NIPT.....

Brenda muajt Gusht 2017

13 - Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Ulzë sot Njësi Administrative e Bashkisë Mat, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullosor ka lidhur Kontratë Qiraje nr. 1881, datë 13.10.2009, me subjektin “V...” sha, me sipërfaqe 300 m² për ndërtim të stacionit të antenave me afat një vit me të drejtë rinovimi, subjekti “V...” sha nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2016 në vlerën **282,000 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin”.

13.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **282,000 lekë** nga subjekti “V...” sha.

Brenda muajt Gusht 2017

14 - Gjetje nga auditimi: Ish-Komuna Lis sot Njësi Administrative e Bashkisë Mat, ka lidhur kontratën qiraje nr. 1874, datë 13.10.2009, me sipërfaqe 300 m² me kompaninë celulare “V...” sha, për vendosjen e antenave dhe gjeneratorëve dhe “M...” sha nr. 397, datë 12.03.2010, për sipërfaqen 400 m², ndërsa kompania celulare “V...” sha nuk ka likuiduar detyrimet e vitit 2015 në vlerën **262,650 lekë** dhe “M...” sha nuk ka likuiduar detyrimet në vlerën **450,000 lekë**, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri me nenin 12, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiarë dhe Kontrollin”.

14.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **262,650 lekë** nga kompania “V...” dhe vlerën **450,000 lekë** nga kompania “M...” sha.

Brenda muajt Gusht 2017

15 - Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se ish-Komuna Komska ka lidhur kontratë qiraje datë 22.08.2014 me subjektin “S...” shpk me NIPT, për shfrytëzimin e sipërfaqes së fondit pyjor/kullor për sipërfaqe 3600 m² ose 0.36 ha dhe pjesë për rrugë kalime me gjatësi 3.2 km, për ndërtim hidrocentrali. Afati i kontratës është 6 vjeçar me të drejtë rinovimi, vlera e qirasë vjetore është për shumën 354,480 lekë, e cila nga të dhënat e zyrës së financës është likuiduar. Vlera e qirasë është llogaritur më pak për **98,000 lekë** me dëm ekonomik në buxhet, veprime në papajtueshmëri me VKM nr. 391, datë 21.06.2006 të ndryshuar me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të Kullotave”, lidhjes 2, pika 11/6.

15.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të marrë masa, të bëjë ndryshimin e kontratës së qirasë sipas dispozitave të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe të ndjek të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin nga subjekti “S...” shpk të vlerës **98,000 lekë**.

Brenda muajt Gusht 2017

16 - Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i dokumentacioni teknik në objektin: “Ndërtim i Rrugës së Varrezave”, Bashkia Mat, rezultuan diferenca më tepër në vlerën **1,369,800 lekë** pa tvsh, nga të cilat vlera **601,400 lekë** pa tvsh për punime të pakryera në fakt dhe vlera **768,400 lekë** si pasojë e ndryshimit të zërave të punimeve pa u shoqëruar me çmimin përkatës, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm për buxhetin e Bashkisë, në kundërshtim me kushtet e kontratës datë 24.03.2015 dhe preventivin e paraqitur në tender, veprim në papajtueshmëri me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 18.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar dhe pikën 3.2 e 3.3, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

16.1 - Rekomandim: Bashkia Mat të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **1,369,800 lekë pa tvsh** nga BOE “E...” shpk dhe “B...” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën pa numër, datë 24.03.2015.

Menjëherë

17 - Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi në terren i dokumentacioni teknik në objektin: “Rikonstruksion i fasadave dhe zëvendësimi i ndriçimit në rrugët: “Kokë Malci”, “Rexhep Pashë Mati”, “Kuvendi i Dukagjinit” dhe trotuaret për rrugën “Kuvendi i Dukagjinit”, Bashkia Mat, rezultuan diferenca më tepër në vlerën **3,611,660 lekë** pa tvsh, që përbën shkelje të disiplinës financiare me dëm për buxhetin e Bashkisë, veprim në papajtueshmëri në kundërshtim me kushtet e kontratës datë 24.03.2015 dhe preventivin e paraqitur në tender, nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 18.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, të ndryshuar dhe pikën 3.2 e 3.3, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

17.1 - Rekomandim: Bashkia Mat të marrën masa, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës **3,611,660 lekë** pa tvsh nga BOE “M...” shpk dhe “S...” shpk, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 823, datë 25.05.2015, nga likuidimi i punimeve të pakryera.

Menjëherë

B/1. SHPENZIME ME EFEKT NEGATIV NË BUXHETIN E BASHKISË:

1 - Gjetje nga auditimi: Në auditimin e procedurave të prokurimit në tenderat e zhvilluar, u konstatuan se në 6 procedura prokurimi me vlerë kontrate **43,792,360 lekë** (me tvsh), ka mos përmbushje të rregullave të caktuara në procedurat e prokurimit, mos përdorim me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike të vëna në dispozicion, veprime në kundërshtim me nenin 1, 2 dhe 24, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe kreu V, pika 1/a dhe pika 4/h, të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

1.1 - Rekomandimi: Bashkia Mat të eliminojë praktikat që çojnë në efektivitet të ulët të prokurimeve për mallra e shërbime. Për të ardhmen Bashkia Mat të mos kualifikojë operator ekonomik të cilët nuk plotësojnë kërkesat për kualifikim.

Në vijimësi

C. MASA DISIPLINORE:

1. Për punonjësit që janë pjesë e shërbimit civil.

C. I - Mbështetur në nenin 58 “llojet e masave disiplinore” shkronja “c”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil” dhe nenin 64 germa g dhe k të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë që ti kërkojë Komisionit disiplinor, pranë Institucionit Tuaj, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet” parashikuar në nenin 58 shkronja (b), për **9 punonjës sa vijon:**

1 – V.B. me detyrë Përgjegjëse e Zyrës së Financës, aktualisht Përgjegjëse e Sektorit të Buxhetit, për shkeljet e trajtuar në faqen 16-19, 30-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

2 – D.T. me detyrë ish-Përgjegjëse Zyrës së Financës në komunën Komsj, aktualisht specialiste finance në Bashkinë Mat, për shkeljet për shkeljet e trajtuar në faqen 93-121, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

3 – N.O. me detyrë ish-Përgjegjës i Zyrës Financës në komunën Rukaj, aktualisht specialist i ndihmës ekonomike në NJA Rukaj Bashkia Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 114-119, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

4 – V.S. me detyrë Drejtor i Politikave të Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë e Pyjeve për periudhën 22.04.2016 e në vazhdim, për shkeljet e trajtuar në faqen 188-205 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

5 – B.B. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Taksave nga 01.05.2016 e në vazhdim, për shkeljet e trajtuar në faqen 181-185 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

6 – A.P. me detyrë specialist në Zyrën e Shërbimeve në Bashkin Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 188-205 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7 – E.K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik në Bashkin Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 126-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8 – M.B. me detyrë Specialist i ndihmës ekonomike në Njësinë Administrative Ulzë, Bashkia Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 126-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9- B.K. me detyrë specialiste urbanistike në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 126-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

C. 2. Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen sipas Kodit Punës.

Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, germa e dhe ç neni 11, kreu IV, neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe neni 11 e 12, të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dhënien e masave disiplinore “Vërejtje”, për 13 punonjës si më poshtë:

1 – D.K. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës, për shkeljet e trajtuar në faqen 30-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

2 – S.M. me detyrë ish-Përgjegjës i Qendrës Kulturore, aktualisht specialist në Qendrën Kulturore Bashkia Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 35-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

3 – A.Xh. me detyrë specialist kulture në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 93-121 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

4 – A.N. me detyrë jurist në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 45-51, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

5 - Sh.L. me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Financës, aktualisht specialiste e ndihmës ekonomike në nja Baz, Bashkia Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 81-87, të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

6 – H.Ç. me detyrë ish-Përgjegjëse e Zyrës së Financës, aktualisht specialiste e ndihmës ekonomike në NJA Derjan, Bashkia Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 87-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit;

7 – E.D. me detyrë ish-Specialist i Pyjeve në Komunën Koms, aktualisht specialist Pyjesh në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 200, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8 – E.LI. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Infrastrukturës në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 126-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9 – E.C. me detyrë jurist në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 126-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10- A.Gj. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Urbanistikës në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 126-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11 – B.K. me detyrë specialist IT në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 126-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

12 – Gj.B. me detyrë inspektor shërbimesh në Njësinë Administrative Ulzë, Bashkia Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 126-167, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

13 – Y.B. me detyrë specialist finance në Bashkinë Mat, për shkeljet e trajtuar në faqen 93-97, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Shënim: Në mënyrë më të hollësishme shkeljet për secilin person në Rubrikën C- Masa disiplinore, janë trajtuar në ANEKSIN Nr. 16, bashkëlidhur këtij Projekt/Vendimi.

E. MASA ADMINISTRATIVE:

Për Inspektoratin e Mbrojtjes Territorit Vendor (IMTV) Bashkia Mat.

- Mbështetur në ligjin nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për Inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, nenit 12 Kreun III neni 15 dhe 16, të ligjit nr. 8402, datë

10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 3 Kreu II, të UKM nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe bazuar në nenin 15 germa c dhe ç të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, **i rekomandojmë** Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Mat, që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur sanksionet “**Dënimin me gjobë**”, për mbikëqyrësin e punimeve si më poshtë:

1 - Ing. D.Q. nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, **të vendosë masë administrative me gjobë në vlerën 200,000 lekë**, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të kontratës me objekt: “Rikonstruksion i Fasadave dhe Zëvendësimi i Ndriçimit” në Rrugët: “Koke Malçi”, “Rexhep Pashë Mati”, “Kuvendi i Dukagjinit” dhe Trotuaret për Rrugën “Kuvendi i Dukagjinit”, Bashkia Mat, me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerën 3,611,660 lekë pa tvsh për punime të pakryera.

F. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL:

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, (Njësia e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionarin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, të ndryshuar.

G. PËR VLERËSIM ORGANIT TË PROKURORISË TË RRETHIT GJYGJËSOR MAT.

Nisur nga disa mangësi dhe shkelje ligjore të konstatuara dhe të trajtuara në Raportin Përfundimtarë të Auditimit në Bashkinë Mat, ky Raport do të përcillet Organit të Prokurorisë për dijeni dhe vlerësim.

I. PËR KLSH

Auditimi i kryer në Bashkinë Mat dhe 7 ish-Komunat (aktualisht Njësitë Administrative) respektivisht: Macukull, Lis, Derjan, Rukaj, Baz, Komsa dhe Ulzë, për pjesën e prokurimeve publike, vlerësohet dobët nga Kryetari KLSH dhe për të kontrolluar cilësinë e punës audituese do të riauditohet në një kohë të dytë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësisë të Qeverisjes Vendore dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R